REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 222/17
Datum. 17.07.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEK-17-1306-1-1-1**

Sa i përket tenderit për: **"Furnizim me pajisje personale mbrojtëse"** LOT 2.

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

N.T.SH."M.S.MEDICOM"
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Major Mehmet Bushi H6/1; Prishtine
(Adresa)

Prishtine
(Vendi)

10000
(Kodi postar)

+381 38 [redacted]
(Numri Telefonit)

+381 38 [redacted]
(Numri i Faks-it)

Edmond Obertinca
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

[redacted]
(Adresa elektronike)

17 Korrik 2017
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

N.T.SH. Medicom Dräger authorized dealer
Major Mehmet Bushi H6/1 Tel. +381 38 [redacted]
Prishtinë-Kosovë office@medicom-ks.com

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

brenda afateve kohore me legjislacionin e aplikueshëm.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] Jo [ ]

Operatori Ekonomik Ankues ka marrë pjesë në hapje të tenderit, dhe gjatë procedurave të hapjes nuk është vërejtur parregullsi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po [x] Jo [ ]

Kundër vendimit për tenderuesin e pasuksesshëm operatori ekonomik ankues ka paraqitur kërkesë për Rishqyrtim, kjo në përputhje me nenin 108 "A" të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Kërkesa për Rishqyrtim është refuzuar me arsyetimin se në ofertën e Operatorit Ekonomik Ankues nuk ka dhënë dëshmi se Operatori i Rekomanduar për Kontratë është i papërgjegjshëm. **Në anën tjetër, Operatorik Ekonomik ankues i është refuzuar e drejta ligjore për qasje në ofertën e operatorit të rekomanduar, kjo me arsyetimin se Operatori i rekomanduar ka kërkuar që e tërë oferta e tij të mbetet konfidenciale – sekret afarist.**

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ky aktivitet i prokurimit është karakterizuar me shkelje të rënda të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.

04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 (Tutje i referuar si" LPP apo Ligji i Prokurimit) dhe shkelje të parimeve kryesore të një procesi të prokurimi, i cili përfshinë transparencën dhe të drejtën për analizën e

Dispozitat e shkelura të LPP-së nga ana e Autoritetit Kontraktues konsistojnë në:

Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës - Operatorik Ekonomik Ankues i është refuzuar qasja në dokumentet e aktivitetit tenderues, më saktësisht në dosjen e operatorit të rekomanduar përmes të cilit përcaktohet nëse ai është i përgjegjshëm apo jo.

Neni 11 Informatat Sekrete Afariste – Informatat të cilat lidhen me Certifikata e produkteve dhe përgjegjshmërinë e tyre nuk mund të klasifikohen si informata sekrete afariste. Edhe në rast se do klasifikoheshin pjesë të tyre si informata sekrete, Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar që të përgadisë një version i cili i paraqet të dhënat e dokumentit në mënyrë të përgjithshme dhe duke fshehur pjesën e sekretetit. Kjo në përputhje me paragrafin 3 të Nenin 11.

Nenin 59 për Ekzaminimin, Vlerësimin dhe Krahasimin e Tenderëve – Përmes refuzimin të kërkesës për qasje, është e pamundur të vlerësohet nëse ekzaminimi është bërë në përputhje me LPP-në. **Për shkak se operatori i rekomanduar për kontratë ka dyshime se ka aplikuar me pajisje të vetë Operatorit të pasuksesshëm, ka dyshime të bazuara se ai nuk i ka certifikata e kërkuara me dosje të tenderit.**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues, bazuar në kërkesën e Operatorit Ekonomik, **ka klasifikuar të gjitha informacionet e Ofertës së operatorit tjetër, si informacione sekrete afariste.** Të vetmet informacione të cilat i ka lejuar si dokumente ku lejohet qasja kanë përfshirë Deklaratën nën Betim, Certifikatën e Regjistrimit Biznesit TVSH dhe numri fiskal, dhe përshkrimi i cmimeve.

Për shkak se ka pasur dyshime të bazuara se Operatori Ekonomik nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit, **kjo në raport me certifikatat e kërkuara me dosje të tenderit dhe Autorizimet,** Operatori Ankues ka kërkuar qasje në dosjen e tenderit. Kjo qasje është refuzuar, dhe Autoriteti Kontraktues ka theksuar se vetë është bindur se i plotëson kushtet e tenderit. Kjo duke refuzuar kërkesën për qasje në dosjen e tenderit.